



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Nr.Regj. Themeltar 8739/4116/1861

Date 29.10.2014

Nr. 1707 Vendimi

Date 16.06.2016

V E N D I M

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata Administrative e Apelet e perbere nga gjyqtaret :

KRYESUES : ARTUR MALAJ

ANETARE : FJORALBA PRIFTI

ANETARE : BLERONA HASA

asistuar nga sekretare gjyqesore [redacted], ne dhome keshillimi te dates 16.06.2016, mori ne shqyrtim çeshjen qe u perket paleve :

PADITese :

[redacted] sh.a

I PADITUR :

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi

PERSON I TRETETE :

[redacted]

OBJEKTI :

Anullim i aktit Administrativ, Vendim nr. 66, date 27.05.2013 i Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

BAZA LIGJORE : Neni 33 i Ligjit nr.10221, date 04.02.2010 "Per mbrojtjen nga diskriminimi"; Ligji nr. 8485, date 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative"; Neni 324 e vijues te Kodit te Procedures Civile.

Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin Nr. 2917, dt. 04.06.2014, ka vendosur:

- Ti ktheje paditesit kerkesepadine se bashku me aktet.

Kunder vendimit Nr. 2917, dt. 04.06.2014, te Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane, ka paraqitur ankim pala paditese, Shoqeria [redacted] sh.a, qe kerkon prishjen e vendimit dhe dergimin e ceshtjes per rigjykim prane te njejtës gjykate, duke parashtruar keto shkaqe:

- Personi i trete ne gjykim ka qene ne marredhenie pune me paditesin, [redacted] Sh.a., qe nga data 15.10.2009. Ne date 31.10.2011 personi i trete ka marre lejen e lindjes brenda te gjithë rregullave ligjore sic percaktohet ne Kodin e Punes dhe aktet e tjera ligjore dhe nenligjore.
- Para perfundimit te lejes se lindjes, personi i trete, me date 24.10.2012 ka kerkuar nga punedhenesi i saj marrjen e lejes vjetore te vitit 2011 dhe ate te vitit 2012, kjo e fundit korrespondon me periudhen gjate te ciles personi i trete ka qene me lejen e barre lindjes. Ne perputhje te plote me parashikimet e Kodit te Punes, kerkesa per marrjen e lejes vjetore eshte refuzuar per shkak te mbingarkeses ne pune. Bazuar ne Nenin 33/4 te Ligjit Nr. 10221/2010 "Per Mbrojtjen nga Diskriminimi", personi i trete ka paraqitur nje ankim formal prane Komisionerit per Mbrojtjen ndaj Diskriminimit, ankim i cili ju nenshtrua shqyrtimit nga ky i fundit.
- Ky institucion, pas perfundimit te procedures se hetimit administrativ, doli me vendimin nr. 66, date 27.05.2013 dhe brenda afatit ligjor paditesi i eshte drejtuar

Gjykates se Rrethit Gjyqesore Tirane. Ne disa seanca te zhvilluara ne Gjykatën e Shkalles se Pare Tirane, personi i trete ka marre dijeni rregullisht ne me shume se dy seanca gjyqesore. Duke qene se ceshtja nuk ishte perfunduar ne kete gjykate dhe si rrjedhoje i fillimit te funksionimit te Gjykatave Administrative, kjo dosje kaloi per kompetence gjykimi prane Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane. Ne kete gjykate, u zhvilluan disa seanca, por duke qene se nuk u arrit qe fletethirrja ti komunikohet personit te trete, u vendos: kthimi i akteve.

- Ne kushtet kur provohet se personi i trete ka marre dijeni rregullisht per seancat gjyqesore te zhvilluara ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, ne po te njejten adrese, Gjykata nuk mund ta konsideronte padine me te meta per shkak se adresa e personit te trete nuk qe e plote. Po ti referohemi Flete-Thirrjeve qe Gjykata e Rrethit Gjyqesor ka derguar ne emer te personit te trete, konstatohet se ky i fundit ka marre dijeni ne me shume se dy here per datën dhe oren ku do te zhvillohej shqyrtimi i padise ne Ijale edhe pse ka preferuar te mosparaqitet. Ne seancen e pare te zhvilluar ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare, Tirane, (dt. 07.04.2014) Gjyqtari informon palen e paditur, se fletethirrja nuk i ishte komunikuar Znj. [REDACTED] ne cilesine e personit te trete ne kete gjykim. Gjykata, bazuar ne nenin 25/1/a te Ligjit nr. 49/2012, ka ftuar paditesin te plotesoje te metat e kerkesepadise, duke kerkuar sakesimin e adreses se personit te trete. Nga ana e [REDACTED] Sh.a., u verifikua e gjitha korrespondenca dhe aktet te ndryshme shkresore te cilat jane depozituar si prova ne kete gjykim dhe u konstatua se personi i trete, ka marre njoftim ne te njejten adrese: Rr. [REDACTED] Tirane.

- Ne seancen tjeter pregatitore, date 24 Prill 2014, gjykata informohet me shkrim nga ana jone ne lidhje me keto konstatime dhe pranon te dergoje perseri flete-thirrjen ne adresen e percaktuar, pra pranon si adrese komunikimi te personit te trete adresen ku jane zhvilluar me pare komunikime me kete person. Ne seancen e fundit, ate te dates 04.06.2014, Gjykata vendosi kthimin e akteve, pasi u konstatua se adresa, sipas shenimit te postes, ishte : adrese e manget. Per sa kohe mbetet e provuar se personi i trete ka marre dijeni me pare per seancat gjyqesore qe zhvilloheshin ne Gjykatën e

Rrethit Gjyqesor Tirane, duhet te kishte vijuar te realizonte njoftimin nepermjet shpalljes per personin e trete sipas kerkesave te Nenit 133 te K.Pr.Civile

- Kthimi i akteve do te thote mohim i se drejtes se aksesit ne Gjykate si pjese e standardit te procesit te rregullt, pasi paraqitja e padise eshte e kushtezuar nga afate dekadente. Duke qene se jemi perpara nje padie, paraqitja e te ciles eshte e kushtezuar nga afate dekadente, kthimi i akteve eshte i barasvlefshem me mohimin ushtrimit te se drejtes se ankimit ndaj nje akti administrativ me pasoja per paditesin. E drejta per te shteruar te gjitha mjetet e ankimit gjyqesor eshte gjithashtu nje e drejte e garantuar edhe nga Kushtetuta jone, rrjedhimisht kthimi i akteve nuk i le paditesit mundesi tjeter per te kundershuar ne rruge gjyqesore aktin administrativ objekt i padise duke i mohuar ne kete menyre aksesin ne gjykate.

GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

Pasi degjoi relatimin e gjyqtarit Artur Malaj ne dhome keshillimi:

VEREN

Rrethanat e faktit :

Subjekti [REDAKTUAR] sh.a ka paraqitur padine me objekt : Anullim i aktit administrativ, Vendim nr.66 date 27.05.2013 i Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Ne seancen pergatitore date 07.04.2014, personi i trete [REDAKTUAR] nuk eshte paraqitur , dhe ne fletethirrjen e dates 19.03.2014 eshte plotesuar rubrika "i panjohur", dhe gjykata ka konstatuar qe kerkespadia eshte me te meta, pasi nga pala paditese nuk eshte dhene adresa e sakte e personit te trete. Ne kete seance nga ana e Gjykates Administrative te Shkalles se Pare

Tirane eshte marre vendimi i ndermjetem per plotesimin e te metave te kerkese padise, e mete e cila konsistonte ne adresen e pasakte te personit te trete, percaktuar ne kerkesepadi.

Per plotesimin e ketyre te metave, pales paditese i eshte lene afat deri ne date 04.06.2014, ora 13.00.

Ne seancen pergatitore te dates 04.06.2014, gjykata ka konstatuar se paditesi nuk ka plotesuar te metat e kerkesepadise.

Vleresimi i Gjykates Administrative te Shkalles se Pare Tirane :

Gjykata ka cmuar se, te metat e kerkesepadise nuk jane plotësuar brenda afatit te caktuar prej gjykates, dhe ne keto kushte ka vendosur ti ktheje paditesit kerkesepadine se bashku me aktet, kjo bazuar ne nenin 154/a te K.Pr.Civile, ne te cilen parashikohet se: “ Kur paditesi nuk plotëson te metat brenda afatit te caktuar kerkesepadia quhet se nuk eshte paraqitur dhe i kthehet paditesit se bashku me aktet”.

Vleresimi i ceshtjes nga Gjykata Administrative e Apelit :

Së pari gjykata vlereson te evidentoje kompetencen e saj per shqyrtimin e ankimit objekt i ketij gjykimi. Ne referim te nenit 7, nenit 10 dhe nenit 44 te Ligjit Nr. 49/2012, kjo gjykate ka kompetencen lendore dhe funksionale per gjykimin e kesaj ceshtjeje.

Së dyti vlereson te marre ne shqyrtim kushtet e pranueshmerise se ankimit. Sikurse eshte referuar edhe me siper ne kete vendim, rezulton qe vendimi te jete shpallur ne daten 04.06.2014, kurse ankimi nga pala paditese eshte paraqitur ne daten 06.06.2014, pra brenda afatit pese ditor, te percaktuar ne nenet 443 paragrafi i fundit dhe 444 paragrafi i pare te K.Pr.Civile. Po keshtu, nuk rezulton te ekzistojne kriteret penguese te parashikuara ne nenin 45 te Ligjit Nr. 49/2012 qe e bejne vendimin te paankimueshem. Ankimi rezulton te jete i plote edhe ne elementet e tjere, si ne elementet e formes edhe te permbajtjes, lidhur me nenshkrimin nga pala qe e ka paraqitur, tregimin e paleve ndergjyqese, vendimin kunder te

cilit është paraqitur ankimi, apo kërkimet për të cilat ai është paraqitur. Për të gjitha sa më sipër gjykata e cmon se ankimi i paraqitur kundër vendimit Nr. 2917 datë 04.06.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, objekt gjykimi, duhet të pranohet për shqyrtim.

Së treti Gjykata Administrative e Apelit e cmon se vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit dhe si i tillë duhet prishur dhe çështja duhet dërguar për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, për arsyet e mëposhtme:

Në nenin 25/1/a të Ligjit nr.49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, parashikohet se:

“ Për zhvillimin e gjykimin, sipas parimit të një procesi të rregullt gjyqësor dhe brenda afateve të shpejta e të arsyeshme, gjyqtari kryesues, brenda 7 ditëve nga data e paraqitjes së padisë, kryen këto veprime:

- a) *I kërkon paditesit plotësimin e të metave të padisë, duke i caktuar atij një afat, deri në 10 ditë. Kur paditesi nuk plotëson të metat e padisë, brenda afatit të caktuar, gjyqtari jep vendim për kthimin e padisë dhe të akteve, që i bashkelidhen asaj. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i vecantë “.*

Referuar dispozitës së mësipërme, gjykata e cmon se:

Kjo padi është depozituar në fillim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, qysh në datë 27.06.2013, dhe rezultoi se pranë kësaj gjykatë janë bërë disa sënca gjyqësore nga ku rezultoi se personi i tretë është njoftuar në po atë adresë që ka paraqitur paditesin, dhe ka marrë dijeni, dhe konkretisht Flete- thirrje datë 12.09.2013 nr. Akti 15123, Flete-thirrje datë 07.11.2013 nr. Akti 15123, Flete – thirrje datë 03.12.2013 nr. Akti 15123, Flete-thirrje datë 16.12.2013, nr. Akti 15123, eka do të thote se paditesi ka dhënë adresë të saktë të personit të tretë dhe jo adresë me të meta apo adresë e pamjaftueshme.

Gjykata cmon se adresa e personit te trete, e dhene nga paditesi ne Gjykatën Administrative te Shkalles se Pare Tirane eshte e njejte me adresen me te cilen Gjykata e Rrethit Gjyqesor ka njoftuar personin e trete dhe kjo adrese nuk ka pasur te meta, pasi personi i trete ka marre dijeni, mbi seancat e zhvilluara ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane, pavarësisht se nuk marre pjese ne keto seanca.

Gjykata cmon se, kthimi i padise i ka hequr efektivisht paditesit mundesine e aksesit ne gjykate, pasi inicimi i nje procesi te ri do te ishte i pamundur ne kushtet kur objekt gjykimi eshte anulimi i nje akti administrative, kundërshtim qe mund te behet ne gjykate brenda afateve te caktuara rigorozisht nga ligji, afate qe ne rastin ne shqyrtim jane ezauruar.

Duke u bazuar në sa me sipër, Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenin 50, germa “ç” të Ligjit Nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, përfundimisht cmon se vendimi i Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Tirane duhet prishur dhe çështja duhet derguar për rigjykim në po ate gjykate me e njejtin gjykues.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Administrative e Apelit, bazuar në nenet 49 e 50, germa “ç” te Ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrveshjeve administrative”, i ndryshuar.

VENDOSI

- Prishjen e vendimit Nr. 2917 date 04.06.2014 te Gjykares Administrative te Shkalles se Pare Tirane dhe dergimin e çështjes për rigjykim në ate gjykate me te njëjtin trup gjykues.

- Kunder ketij vendimi lejohet e drejta e rekursit ne Kolegjin Administrativ te Gjykates e Larte, brenda 30 diteve duke filluar ky afat nga dita e komunikimit te vendimit.
- U shpall, sot me date 16.06.2016 ne Tirane.

ANETARE

ANETARE

KRYESUES

FJORALBA PRIFTI

BLERONA HASA

ARTUR MALAJ

dv

dv

dv

Vertetohet njesia me origjinalin

Kancelari

Leonard Strataj